



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi-ks.org

Nr. 754/13 dt. 29.10.2013

Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), dhe Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Larte (Nr. 14/2003), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.2/2009), dhe Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e mbajtur më 24 Tetor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht ankesa e datës 04.09.2013, nr.1/988 e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë me të cilën kërkohej rishqyrtimi i vendimit të KSHC-së të datës 03.07.2013, nr. 489/13.
2. Akreditohet programi i studimit Konstruktiv MSc për periudhën një vjeçare 01 Nëntor 2013- 30 Tetor 2014.
3. Ky vendim ndryshon vendimin e KSHC-së të datës 03.07.2013, nr. 489/13 sipas pikës dy të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në rekomandimin përfundimtar të ekipit të ekspertëve të akreditimit, dhe fakteve të ofruara nga institucioni, KSHC vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet;

- Universitetit "Hasan Prishtina, Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
- MASHT
- Arkivit të AKA-së



Dr.sc. Ferdije Zhushni Etemi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

